



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 2, datë 06.03.2024

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 06.03.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar ! Të nderuar të pranishëm!

Në këtë mbledhje, siç jeni në dijeni dhe nëpërmjet email-it të dërguar nga Sekretaria, do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë dhe Komisioni i Mandateve. Ftoj sekretaren të proçedoj me thirrjen e emrave të Këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje.

Fillojmë. Ardian Muka ... Prezent.....deri tek.... Florian Tahiri...Mungon.

40 Këshilltarë në sallë.

V.O... (Hyn me vonesë Marsida Feshti dhe Blerina Reçi. Gjithsej 42 këshilltarë....

....Gjatë mbledhjes largohen nga salla këshilltarët Dritan Burgija dhe Luan Nezha.)

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës. Sot për shqyrtim e miratim kemi **19** pika .

Pika 1.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARES ZNJ.ALNEIDA RROSHI
Pika 2.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHKURT 2024
Pika 3.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DURRËS, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE NDËRTIMI 199 M ² , DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 21.4 M ² , E NDODHUR NË KATIN E PARË TË GODINËS SË SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR ME ORIENTIM ARTISTIK “JAN KUKUZELI”
Pika 4.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR NJË SHITESË NË KONTRATËN E QIRASË, QË MBAN NR. 12644 PROT., DATË 30.7.2019, E LIDHUR NDËRMJET BASHKISË DURRËS, SI QIRADHËNËS DHE SHOQËRISË “UNIEURO” SHPK, SI QIRAMARRËS, TË SIPËRFAQES SË PËRGJITHSHME 262.6 M ² , KU SIP. NDËRTIMI 257.7 M ² DHE SIP. FUNKSIONALE 5 M ² DHE MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T’U DREJTUAR MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR EKONOMINË PËR VAZHDIM PROCEDURE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR PËRFSHIRJEN E SIPËRFAQES SHITESË ME TARIFËN 1 EURO
Pika 5.Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 64, DATË 07.07.2020, VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 81, DATË 10.08.2020 DHE VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 55, DATË 26.06.2020 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR

Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 67, DATË 14.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. HASAN HYSEN GJOKA, NR. 145, DATË 28.09.2023 PËRSA I PËRKET Z. GJON SHTJEFNI, NR. 36, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET Z. MUSA MUSAI, NR. 104, DATË 19.10.2022 PËRSA I PËRKET ZNJ. OGERTA DHAMO, ZNJ. VALENTINA SHTAMARI DHE ZNJ. JULIANA SHTAMARI
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMEVE PËR DHËNIEN E TITUJVE VENDORË TË NDERIT PRANË BASHKISË DURRËS
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT 4 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 86, DATË 31.08.2020, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1,4, 5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, ISHËM, BASHKISË DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE SHKALLNUR, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS PËR ZHVILLIM KOMUNITAR “SOT PËR TË ARDHMEN”, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 169.5 M ² , KU SIPËRFAQE NDËRTIMI 155 M ² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 14.5 M ² , E NDODHUR NË KATIN E PARË TË BANESAVE SOCIALE, ME NR. PAS. 5/270, ZK 8513, LAGJA NR. 17, RRUGA “DALIP PEZA”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 5 (PESË) VJET
Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT, QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2024

Pika 12. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VKB-NË NR. 196 DATË 22.12.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024”
Pika 13. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË PROGRAMIT TË KREDISË SË LEHTËSUAR PËR STREHIM ME 3% INTERES PËR VITIN 2024
Pika 14. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJES SPAHO, SI SUBJEKT PËRFITUES NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, RRUGA "ISMET NANUSHI", PALLATI NR.12/2, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 15. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.61, DATË 28.02.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 16. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDREQJES SË GABIMIT ME KARAKTER MATERIAL NË PASQYRËN NR.4, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 195 , DATË 22.12.2023, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024 - 2026 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024”
Pika 17. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË RINDËRTIMIT TË PASHPENZUARA NË VITIN 2023, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2024
Pika 18. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS , TË GODINËS DY KATËSHE ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 362.7 M ² , KU SIPËRFAQE E NDËRTIMIT KATI PËRDHE 196.5 M ² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE DHE E LIRË 166.2 M ² , E NDODHUR NË LAGJEN NR. 16, RRUGA “MBRETI GENT”
Pika 19.	PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK

Propozim dhe miratim	
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Atëhere, përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Po z. Xhelili.

Roland Xhelilaj: Përshëndetje !

Në emër të Grupit të Këshilltarëve Socialist, kërkoj që pika numër 19 të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Duke marrë në konsideratë që sot kemi pikën e parë për lirim ose lënien e mandatit nga zonja Rroshi, kërkojmë që të na jepet mundësia, që në mbledhjen e radhës të përcaktojmë ose të paraqesim kandidaturat për Nënkryetar të Këshillit.

Ani Dyrmishi: Tjetër koment ?

Atëherë nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës, duke hequr pikën 19?

Ardian Muka : Pikën 19?

Ani Dyrmishi: Po.

41 Pro.

Kundra?Nuk ka.

Abstenim?Nuk ka.

Atëherë miratohet rendi i ditës pa pikën 19.

- Kalojmë **në pikën 1**, I japim fjalën Komisionit të Mandateve, znj. Dhamo.

Ana Dhamo: Përshëndetje!

Përsa i përket pikës 1 u mblodh Komisioni i Mandateve dhe pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga Sekretaria e Këshillit Bashkiak, u pa që detyra e këshilltarit të znj. Alneida Rroshi ishte e papërputhshme me Ligjin 139/2015, neni 47, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, duke qenë se znj. Rroshi ka marrë detyrën e Drejtorit Ligjor pranë Bashkisë Durrës dhe komisioni propozon që këtë pikë ta kalojmë në votim në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, ka?

Komente nuk ka. Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1?

Kundra?....

Abstenim?.....

Me 40 vota pro miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, znj. Doçi.

Xhiliola Doçi: Komisioni u mbledh dhe votoi me unanimitet votash që pika 2 të kalojë për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 2, ka?

Komente nuk ka. Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 2 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëherë me 40 vota pro miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 3**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë në votim në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, z.Paja?

Ilir Paja: Komisioni ra dakort dhe e kalon në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor me unanimitet e kalon për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit!

Atëherë komente përsa i përket pikës 3, kemi?

Komente nuk ka. Kalojmë për votim.

Kush është pro? ...

Kundra? ...

Abstenim? ...

Atëherë me 39 pro, 1 pavotuar, miratohet pika 3.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 4**, Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike, znj. Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit Kryetar.

Komisioni u mblodh dhe pasi shqyrtoi çështjen, vendosi ta kalonte për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Markola.

Hekuran Markola: Edhe pikën 4 ky komision e kalon me unanimitet për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 4, kemi?

Po z. Muka.

Ardian Muka: Mirëdita!

Për pikën 4 natyrisht që përgëzojmë shoqërinë private, e cila ka marrë një sipërfaqe që është në funksion mbi 900 metra, ndërkohë në 262 ka investuar zonën, ka puntorë, ka kryer investime. Thjesht unë pata një kërkesë dhe te komisioni, ja parashtrua pastaj dhe punonjësve të Bashkisë, që për kërkesën që ato bëjnë për 262 metra, meqenëse kjo i kalon dhe për kompetencë ministrisë pastaj, megjithëse ato për momentin 262-shin e kanë me qera nga Bashkia, do i kalojë me sistemin 1 euro, për kohëzgjatjen, meqenëse dhe këtu jemi të paqartë.

Pra kohëzgjatja do të jetë 8 vite dhe për 262 metrat apo dhe këtë e vendos ministria dhe del nga kompetencat e Këshillit Bashkiak, ne për momentin thjesht japim okej (okay)?

Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Po, z.Kallmi.

Gentian Kallmi: Përshëndetje të gjithëve!

Përsa i përket pyetjes tuaj, siç jeni sqaruar dhe gjatë komisionit, dhe këtu dua mirëkuptimin e të gjithëve që pyetjet që diskutohen gjatë komisionit dhe ezaurohen aty të mos bëhen pjesë e mbledhjes. Gjithsesi përsa i përket vendimit, është cituar që është një shtesë e kontratës bazë. Kështu që do të eci paralelisht me kontratën bazë. 8 vite. Përfundimi është në 2027 i kontratës bazë, bashkë me shtesën e kontratës, se një shtesë kontrate nuk mund të eci e pavarur pa kontratën bazë.

Ardian Muka: Te pjesa Bashkisë, të paktën në mbledhje ishte e paqartë, thamë do ta sqarojmë...

Gentian Kallmi: Jo është e cituar dhe në projektvendim që është një shtesë e kontratës, se dhe ligji shtesë të kontratës parashikon.

Ardian Muka: Okej (okay), faleminderit!

Ani Dyrmishi: Koment tjetër për pikën 4?

Atëherë nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 4? ...

Kundra?...

Abstenim... Nuk ka.

Me 39 vota pro miratohet pika 4 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 5**. I jap fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Po kryetar, komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Faleminderit Kryetar.

Për pikën 5 dje në komision ne e votuam dhe propozojmë sot për miratim në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 5, kemi?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 5 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 39 vota pro miratohet pika 5.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 6**. Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike, znj. Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh dhe e shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën 6 propozojmë sot për t'u miratuar në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 6, kemi?

Komente nuk ka, kalojmë për votim.

Kush është pro për miratimin e pikës 6 të rendit të ditës?...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Me 39 vota pro miratohet pika 6.

- Kalojmë **në pikën 7**. I japim fjalën Blerinës. (.....Blerina sa hyri në sallë.....)

Blerina je gati me fol, apo t'ja kalojmë Ilirit?
Jemi tek pika 7.

Blerina Reçi : Le të flas Iliri.

Ani Dyrmishi: Vazhdo z. Paja.

Ilir Paja : Këtë pikë e miratuam dhe vendosëm ta kalojmë në votim.

Flutura Kasa : Ngreje pak zërin.

Ani Dyrmishi: Atëherë faleminderit.

Komente për pikën 7, kemi?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 7 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim? ... Nuk ka .

Atëherë me 40 vota pro miratohet.

Ju lutem ndizni mikrofonat kur merrni fjalën.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 8**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj. Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit Kryetar.

Komisioni u mbledh, e shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere dhe komisioni ynë pikën 8 propozon që ta miratojmë sot.
Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 8, kemi?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ...

40 vota pro miratohet pika 8.

- Kalojmë **në pikën 9**. Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj. Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për miratim në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Komisioni i Pronave u mbledh dhe me unanimitet e kalon për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 9, kemi?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

40 vota pro miratohet pika 9.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 10**. Znj. Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit .

Komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

z. Markola.

Hekuran Markola: Edhe pika 10, me shumicë votash kalon për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 10, kemi nga ana këshilltarëve?

Po z. Muka.

Ardian Muka : Në fakt pas një konsultimi që patëm me sekretaren e këshillit për pikën 10 në komision un gjeta pikëpyetje, meqenëse diskutohet për një sipërfaqe për Qendrën Për Zhvillim Komunitar “Sot Për Të Ardhmen”. Rezultonte që kjo qendër ka dhe një sipërfaqe tjetër po të marrë nga bashkia, por nuk ka kaluar ndërmjet bashkisë, sepse është një fond i marrëveshjes së UNDP-s, dhe ato kanë fituar nga granti që ato kanë. Atëherë meqenëse sot ata kanë një sipërfaqe, që pretendojnë se ato kanë një sipërfaqe në vazhdimësi, është për mendimin tim është okay, po të kishte dy, problemi është që ne kemi dhe shoqata të tjera, të cilat nuk janë krah nacional, janë të përqëndruara në Durrës, me shumë anëtarë, kanë bërë disa kërkesa në bashki. Unë i kam ngrëjt për njërin prej atyre, ku të shihet me përparësi, që edhe për këto shoqata që janë në Durrës, jo se jemi territorialist, por duke qënë se bashkia këtyre shoqatave u jep hapësira pa pagesë dhe janë në shërbim të komunitetit të Durrësit, është kjo llogjikë, që ky këshill meqenëse është në shërbim të qytetarëve durrsak, të përfitojnë direkt dhe këto shoqata.

Natyrisht do të propozoja që të paktën një shoqatë, për mu e rëndësishëme, me 800 anëtarë, e ka për zonjat që janë keqtrajtuar, me probleme të ndryshme sociale, në mbledhjen tjetër do bëjë

kërkesë natyrisht, të dëgjojmë një prezantim të tyre dhe të merret në radhë të parë, nëse do të kishim mundësi, parasysh dhënia e një sipërfaqe zyrash, brenda qytetit të Durrësit për zhvillimin e aktivitetit të tyre.

Këto kisha, thashë në princip, mëqenëse nuk diskutohet për dy, po diskutohet për një sipërfaqe, sot për këtë seancë unë jam dakord. Faleminderit .

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment tjetër?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëherë me 40 vota pro miratohet pika 10.

- Kalojmë **në pikën 11**. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere komisioni ynë pikën 10 e miratoj dhe e propozon që ta miratojmë sot në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 11, kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Me 40 vota pro miratohet pika 11.

- Kalojmë **në pikën 12**. Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj. Reçi.
.....(*...qetësi...*)
Do të vazhdoj z. Paja?

Blerina Reçi : Po

Ani Dyrmishi: Okej (okay).

Z. Paja. Vetëm gërthit pak që të ngjohet.

Ilir Paja: Komisioni e miratoj dhe e kalon në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Atëherë komente për pikën 12?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Me 40 vota pro miratohet pika 12.

- Kalojmë në pikën 13. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe pikën 13 e propozojmë ta miratojmë sot në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 13, kemi?

Kontjana Kuçi: Kam unë një.

Ani Dyrmishi: Po, znj. Kuçi.

Kontjana Kuçi: Tani unë vë re që tek lista, pavarësisht se jam dakord që parimisht jam pro dhënies së ndihmës, të ndihmave ekonomike dhe në shërbim të qytetarëve që kanë nevojë për të gjitha këto dhe të bonusit të familjeve të pastreha, por mendoj që lista ka disa emra që janë të përsëritur, mendoj që disa emra janë të përsëritur, po them 2 ose 3 emra janë të përsëritur. Nuk e di nëse është lapsus apo kanë një qëllim tjetër?

Dhe e dyta shof që disa nga emrat kanë lidhje me këshilltarët që janë të Partisë Socialiste, duhet ta evidentoj këtë, apo dhe me punonjës të bashkisë dhe me ish-punonjës të bashkisë. Kështu që mendoj që një pjesë e listës është për të bërë qokat elektorale të fushatës. Faleminderit .

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Përsa i përket vendimeve për këshilltarët normalisht çdo këshilltar që ka konflikt interesi duhet të deklaroj paraprakisht, nuk besoj që i hiqet e drejta.

Kontjana Kuçi: Jo absolutisht jo, por ideja është që përderisa aplikimi bëhet me e-albania patjetër që e-albania do t'i kaloj të gjitha këto. Por që unë besoj se duhej të paraqitej dhe lista e fituesve dhe atyre që janë skualifikuar dhe përse janë skualifikuar.

Ani Dyrmishi: Nuk e di z. Kallmi, përse i përket procesit të...?

Gentian Kallmi: Përse i përket përsëritjes së emrave mund të jetë lapsus duhet ta verifikojmë.

Kontjana Kuçi: Po, po në mos gaboj janë dy ose tre emra që janë të përsëritur dy herë.

Gentian Kallmi: Po, po do na duhet të verifikojmë. Përse i përket pjesës së përfshirjes së këshilltarëve, familjarëve të këshilltarëve që keni hasur, por besoj që çdo subjekt, individ që përmbush kushtet për strehimin duhet të trajtohet në programin e stehimit, ashtu siç mund të ketë dhe familjarë të këshilltarëve të opozitës.

Kontjana Kuçi : Po, po unë mendoj që ka shumë njerëz të tjerë që kanë nevojë për këtë nga bashkia, dhe ka dy ose tre emra brënda një familje që unë mendoj që qëllimisht është bërë shkëputja dhe ndarja nga trangu familjar dhe sipas asaj liste përfitojnë dy persona nga e njëjta familje.

Gentian Kallmi: Ne trajtojmë kërkesat një nga një dhe nuk e kuptoj qëllimin e kësaj pyetjeje ?!

Hekuran Markola : Kryetar mundem?

Ani Dyrmishi: Pas Fluturës, meqënëse e kërkoj para jush fjalën.

Hekuran Markola : Okej (okay).

Ani Dyrmishi: Flutura ke fjalën.

Flutura Kasa: Përsa i përket atyre emrave që janë përsëritur, kam pyet te Zyra e Shërbimit dhe Strehimit është një lapsus, kështu që nuk është ndonjë problem për tu shqetësuar. Ndërsa për përzgjedhjen e emrave, aty janë disa punonjës që i përzgjedhin, plus i kaluan dhe në Komisionin e Strehimit dhe nuk kalojnë ashtu pa u vënë re, por mos harrojmë që ato kalojnë dhe në sitën e bankës, kështu nuk besoj se mund të ketë ndonjë shqetësim kaq të madh.

Hekuran Markola: Pikërisht këtë do të thoja, për përsëritjen e emrave mos të merakosen fare sepse filtri kryesor janë bankat në këtë rast. Mos harrojmë se gjysma e këtyre emrave nuk do ta përfitojnë nga bankat, kështu që mos u shqetëso fare, se ky filtër është shumë i saktë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

z. Myshketa.

Jonuz Myshketa: Për atë që tha kolegja, pjesën e përsëritjes së emrave atë e kam vënë re dhe unë dhe uroj të jetë lapsus që të mos na ngeli merak.

Ani Dyrmishi: Atëherë e mbyllim këtu.

Përsa i përket korigjimit të emrave të cilët janë të dublikuar të hiqen. Përsa i përket konflikteve të interesit ju lutem këshilltarëve kush është në konflikt është i detyruar ligjërisht ta deklaroj atë para votimit dhe të mos marr pjesë në votim.

Joniada Musaraj: Ka dhe diçka, kur një qytetar aplikon të e-albania, më fal Kryetar, nëse aplikon dikush një kushëri i im i dytë dhe i tretë në e-albania, unë nuk kam nga ta marrë si informacion. Nuk kam konflikt ëë, por po e marr si hipotetike.

Ani Dyrmishi: Jo është tjetër gjë ajo .

Joniada Musaraj: Dhe diçka tjetër, me zonjën Kuçi diskutuam dhe në lidhje me një problem që paraqiti sot, dhe unë me timen ia shpjegova në lidhje me dy anëtarë brënda së njëjtës familje dhe atësia ishte e njëjta dhe supozohet, i bie që të jenë motra. Nëse janë madhor, tani unë nuk e di në ka pengesë, Nënkryetari mund të na e shpjegoj: A ka pengesë ligjore që dy motra të moshës madhore, të cilat duan të ndërtojnë familje më vete, të aplikojnë dhe të marrin nga një gazoniere 1+1-she, që i bie të ndarë? Gazoniere njëra motër, gazoniere motra tjetër.

Ani Dyrmishi: Të ta sqaroj unë këtë. Përsa kohë që t'i ke aplikuar dhe plotëson kriteret bazë sipas ligjit, në të cilën të do përfitosh 3 % nga bashkia, nuk ka pengesë...

Joniada Musaraj :nuk ka pengesë ligjore. Unë e qartë jam, por thjesht për ta verifikuar.

Ani Dyrmishi: Përsa i përket konfliktit të interesit e ka të sqaruar ligji për konfliktet me familjarët, përsa i përket emrave të dublikuar do të hiqen nga lista ato që janë dublikuar, besoj se u zgjidh kjo pjesa.

Kush ka ndonjë koment tjetër?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

40 vota pro miratohet.

- Kalojmë **në pikën 14**. I jap fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit .

Komisioni u mblodh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Po Kryetar.

Atëherë komisioni ynë e miratoi në unanimitet dhe e propozon për miratim në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 14?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 14 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 39 vota pro miratohet.

- Kalojmë **në pikën 15**. I jap fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit .

Komisioni u mblodh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Po Kryetar.

Edhe ne si komision e kalojmë për tu miratuar në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 15, kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 15 të rendit të ditës? ...

Ju lutem mbani pak kartonat lartë.

Atëherë 40 pro, miratohet pika 15.

- Kalojmë **në pikën 16**. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Xhelilaj.
Znj. Flutura, të lutem !...
Z. Xhelilaj ! Pika 16...

Rolant Xhelilaj: Komisioni Ekonomisë dhe Buxhetit vendosi unanimitisht për ta votuar në mbledhjen e Këshillit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 16, ka?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

40 pro miratohet.

- Kalojmë **në pikën 17**. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Dhe për pikën 17, komisioni është dakord të kalojë për votim në këshill, duke pasur parasysh që rialokimi është një proces normal që zhvillohet çdo fillim viti.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 17, kemi?

Po z. Muka

Ardian Muka : Faleminderit. Sipas relacionit, rialokimi i fondeve rrjedh ngaqë në tre pika të ndryshme, po lexoj...

Pika e parë: “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e zbatimit, mbikëqyerjes dhe kolaudit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese” për 892 milion e diçka.

Pika e dytë: “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë” fondi 1 miliard e 490 milion e ca bishta.

Pika e tretë: “ Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në bashkinë Durrës”, të ndryshuar në Bashkinë Durrës fondi 1 miliard e 216 milion.

Pyetja ime është: Duke qënë se fondet në total kanë qënë rreth 44 miliard e 500 e ca milion, nga këto janë përdorur 2 miliard e 692 milion, dhe mbeten pa u përdorur 1 mld e 813 milion, të cilat rialokohen për 2024. Do të doja një sqarim nga ana e bashkisë për të tre fondet të cilat kanë ardhur me mbetje përse nuk janë realizuar? Ne kemi pas fonde dhe ato nuk janë realizuar. Pse, për secilën nga këto projekte?

Dhe pastaj pjesën tjetër mënyra se si bëhet prezantimi për objektet në 2024. Ka shumë objekte të cilat, objekti me numër kaq, kaq, kaq, dhe koordinatat nga sistemi GIS. Jo të gjithë besoj dinë të orientohen apo të arrijnë të krijojnë një ide se kush janë objektet. Thjesht nga ana formale të japin përshkrimin, ky objekt këtë adresë, ky objekt këtë adresë se ky ndodhet ky objekt, mos jepen thjesht koordinatat e GIS-it. Se koordinatat e GIS-it, besoj specialist shumë të specializuar arrijnë ta zbërthejnë që kanë dhe sistemin.

Pra, e para dua një përgjigje përse nuk janë vënë në përdorim fondet e alokuara ?

Dhe e dyta, për këtë është vërejtje : Që përshkrimi duhet të jetë më i qartë.

Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Po.

Gentian Kallmi : Atëhere përse i përket përcaktimit të fondeve, janë fonde të përcaktuara në VKM të alokuara në Bashkinë Durrës, procesi është i vazhdueshëm kontratat janë në proces, është një procedurë rutinë për trashëgimin e fondeve, ashtu siç bëhet trashëgimi i fondeve të buxhetit të bashkisë në mënyrë të përvitshme. Fondet edhe njëherë janë në bashki dhe janë fonde të alokuara për kontratat që janë në zbatim, në proces.

Përse i përket pjesës së kodeve GIS, nuk janë vënë me qëllim kodet GIS, por është vënë emërtimi i kontratës, kontrata emërtohet dhe objekti i kontratës është me kode GIS. Në qoftë se keni ndonjë sqarim ose ndonjë verifikim të kodit GIS, ose të të gjithë kodeve GIS pa merak.

Ardian Muka : Referoj që të gjithë ta kuptojnë. Unë mund të hyj se kam sistemin...

Gentian Kallmi : Okej, okej (okay) të kuptoj.

Aty emërtohet objekti i kontratës i parashikuar në buxhet.

Ani Dyrmishi : Z. Muka besoj që, kërkon që të shkruhen me emrat përkatës të objektit.

Ardian Muka : Jo, jo unë dua që ky projekti i referohet fiks atyre pallateve, adresat e pallateve të cilat do të jenë në procesin e rikonstruksionit, se fondi është i rindërimit, përse thoni që fondet janë në process, prandaj nuk kanë arritur të ezaurohen në vitin ushtrimor

Gentian Kallmi : Kalohen në vitin ushtrimor pasardhës.

Ardian Muka: Pra nuk është që këto fonde janë djeg për 1, 2, 3 apo 4, por është thjesht vazhdimësia.

Gentian Kallmi : Vazhdimësia e vitit kalendarik, e vitit buxhetor.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment tjetër për pikën 17?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 17 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Me 40 vota pro miratohet .

- Kalojmë **në pikën 18**. Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj. Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Markola.

Hekuran Markola: Komisioni i Pronave e kalon në unanimitet për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 18 ?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 18? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Me 40 vota pro miratohet dhe pika 18.

- **Pika 19**, u hoq nga rendi ditës.
- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** z.Osmani.

Sami Osmani : Përshëndetje të gjithëve.

Unë do të ngre dy shqetësime. E para është për rrugën Vala e Detit dhe rruga Azem Hajdari, tek të cilat janë ndërprerë punimet. Një rrugë që nuk ka përfunduar akoma dhe gjëndja e saj është në këtë gjëndje kështu (e tregon me foto). Nuk e di kush mban përgjegjësi për këtë?

Një rrugë e padorëzuar, e cila është në këtë gjëndje. Rruge e re. Fotot flasin vetë që mund të rrezikojnë dhe kalamajtë e shkollës jetën në këto gropa.

E dyta është: Për çfarë janë bllokuar punimet dhe kush e kontrollon cilësinë e këtyre punimeve? Desha një përgjigje për këtë dhe pastaj do të kaloj tek pyetja tjetër.
Faleminderit.

Gentian Kallmi : Referuar pyetjes suaj dua të sqaroj se kjo është një kontratë në proces zbatimi me njësi zbatuese Fondi Shqiptar i Zhvillimit, është kontratë akoma e papërfunduar. Referuar informacioneve nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit jemi në 80 % të realizimit të kësaj kontrate.

Përsa i përket pretendimit se përse janë pezulluar punimet? Punimet janë pezulluar në zonat ku procesi i shpronësimit nuk ka përfunduar ende. Është një proces, që nuk varet normalisht nga institucioni i Bashkisë Durrës, është një grup ndërinstitutional që merret me shpronësimet.

Përsa i përket situatës faktike të një pjese të rrugës, ne pas ankesave të marra jemi paraqitur si institucion, kemi verifikuar rastin, ka rrethqitje dhe i është lënë detyrë zhvilluesit për t'i rikthyer dhe për t'i dorëzuar në gjëndje funksionale.

Sami Osmani : Okej (okay).

Pyetja e dytë është në lidhje me shkollat, për 6 shkollat që janë në rikonstruksion dhe 7 të tjera që janë për rindërtim. Këto shkolla janë :

Shkolla 14 Nëntori që zhvillon mësim mbasdite tek Qemal Mici, është për rikonstruksion.

Shkolla e Bashkuar Rexhep Mezini në Ishëm vazhdon mësimin turni dytë tek Vath Bushi, rindërtim.

Nuk po i them të gjitha se janë 13 shkolla të gjitha. 6 për rikonstruksion pra dhe 7 për rindërtim.

Dua të di këto për këto shkolla. Shpenzimet besoj janë goxha të mëdhaja për transportin e të gjithë këtyre nxënësve për këto shkolla. Ku është faza e këtyre punimeve dhe sa ka për rindërtim?

Kaq, faleminderit.

Gentian Kallmi: Atëherë, në lidhje me pyetjen tuaj, dua t'ju informoj se Bashkia Durrës ka në dispozicion 88 godina arsimore nga të cilat 80 % e godinave i janë ushtruar ndërtimit të ri apo rikonstruksionit nga procesi i rindërtimit ose me fondet e bashkisë. Aktualisht nga rindërtimi kemi përfunduar gjithsej 24 objekte arsimore nga të cilat 20 objekte janë ndërtim i ri dhe 4 objekte në rikonstruksion dhe kemi në proces edhe 14 objekte të tjera arsimore.

Konkretisht pyetja ishte për Rexhep Mezini dhe 14 Nëntorin mos gaboj?

Sami Osmani: Për të 13-ta janë realisht.

Gentian Kallmi: Doni informacione për 13?

Sami Osmani: Po. 7 janë në rindërtim 6 për rikonstrukcion, të cilat nuk kanë filluar akoma. Kur do fillojnë shkollat për rindërtim dhe rikonstrukcion?

Gentian Kallmi: Konkretisht.

Sami Osmani: Shkolla 14 Nëntori?

Gentian Kallmi: Shkolla 14 Nëntori është në proces ndërtimi me afat Qershor 2024.

Sami Osmani: Rexhep Mezini?

Gentian Kallmi: Rexhep Mezini është në proces me afat përfundimi Shkurt 2025.

Sami Osmani: Naim Frashëri?

Gentian Kallmi: Vijon ndërtimin me përfundimin në muajt Prill 2024 dhe brënda muajt Maj përfundon dhe procesin e kolaudimit.

Sami Osmani: Gjergj Kastrioti?

Gentian Kallmi: Gjergj Kastrioti aktualisht ka pezulluar punimet për gërmimet arkeologjike. Bashkia Durrës me fondet e veta ka parashikuar gërmime arkeologjike në këtë zonë për t'i hapur rrugë financimit për vazhdimin e zbatimit të punimeve.

Sami Osmani: Geraldina?

Gentian Kallmi: Geraldina Qeraxhia përbëhet nga shkollë e mesme sportive dhe konvikti me afat përfundimi punimesh Korrik 2024.

Sami Osmani: Eftali Koçi ?

Gentian Kallmi: Eftali Koçi ka përfunduar. Ka filluar mësimi ose fillon mësimi në datën e sotshme.

Sami Osmani: Gjimnazi i Manzës ?

Gentian Kallmi: Gjimnazi i Manzës është në kuadër të procesit të rindërtimit, është parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2024.

Sami Osmani: Zyber Sallaku?

Gentian Kallmi: Zyber Sallaku përfundon brënda muajt Mars 2024.

Sami Osmani: Jusuf Hoti?

Gentian Kallmi: Jusuf Hoti është shkollë e mesme në ndërtim kopësht dhe shkollë fillore, përfundimi në Prill të 2024.

Sami Osmani: Riza Shera?

Gentian Kallmi: Riza Shera në Rat është shkollë 9 vjeçare dhe kopështi, ka filluar puna me 25 Shkurt të 2024 dhe pritët përfundimi brenda vitit.

Sami Osmani: Besnik Hidri?

Gentian Kallmi: Besnik Hidri....s'ka problem se i kemi.

Joniada Musaraj: Osman çdo shkollë ka një tabelë, që nëse i ke parë në terren tabelat kanë të gjitha specifikimet .

Gentian Kallmi: duhet të informoheni që për Besnik Hidri ka filluar mësimi në Shkurt.

Llesh Çuni: S'ka problem ai po hedh kandidate për Drejtor Arsimit.

Sami Osmani: Dhe shkolla 9 vjeçare në Armath.

Gentian Kallmi: Është në proces, e parashikuar me fondet e Bashkisë Durrës objekt në rindërtim në 2024.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Znj. Devolli.

Edlira Devolli: Në fakt pyetjen e kam debozitur që herën e shkuar, por Kryetarja nuk ka qenë dhe nuk është, kështu që po jua drejtoj juve pyetjen.

Sa kohë kanë pa u paguar bonuset e qerave qytetarëve?

Dhe në mbledhjen e datës 3 Nëntor 2023 nga Kryetarja, këtu në këtë sallë është deklaruar se :
.....“ Është detyrimi i Ministrisë së Financave për të bërë pagesat për bonusin e qerasë, dhe se janë bërë dy kërkesa në Ministrinë e Financave për të cilat nuk është marrë përgjigje negative, pra nuk është thënë se nuk do paguhet bonusi“..... citoj këtu Kryetaren e Bashkisë,“Dhe se jemi në pritje të kalimit të fondit dhe me kalimin e financimit do bëhet likuidimi i plotë për familjet që janë në pritje.... ”.

Për interesin e qytetarëve kam kërkuar që në mbledhjen e herës së shkuar, kur kam depozituar pyetjen, zbardhjen dhe vendosjen në dispozicion të korespondencës zyrtare midis Bashkisë së

Durrësit dhe Ministrisë Financiare apo institucione të tjera të shtetit shqiptar të lidhura me këtë çështje, nëse funksiononi me shkresa.

Gentian Kallmi: Faleminderit për pyetjen.

Përsa i përket pjesës së bonusit qerasë, dihet normalisht përsa kohë kanë qytetarët që nuk marrin bonusin. Është një gjë, që nuk po e zbulojmë sot.

Referuar korespondencës, që ju kërkoni Ministria ka sjell një shkresë për shikimin e mundësisë së veprimit dhe angazhimit të fondeve buxhetore të bashkisë për dhënien e bonusit. Kemi pasur që pas kësaj shkrese takime të vazhdueshme me Ministrinë ku i kemi shpjeguar pamundësinë financiare me buxhetin e bashkisë për të proceduar me dhënien e bonuseve, kemi bërë një analizë të detajuar si bashki dhe kemi vendosur që buxheti për vitin 2024, këto fonde që ne mendojmë t'i alokojmë për rindërtimin, t'i alokojmë për objekte për të cilat nuk kemi financim dhe besoj se e kemi deklaruar dhe në mbledhjen paraardhëse në mënyrë që, të zgjidhet problematika dhe jo të zvaritet nëpërmjet dhënies së bonuseve. Domethënë fondet që ne mendojmë të angazhojmë me buxhetin e bashkisë kemi menduar që është më e drejtë të shkojnë në objekte sesa në bonuse.

Edlira Devolli: Duke qenë se nuk është thënë asnjëherë që nuk do paguhet bonusi, kjo përgjigja juaj sot është që bonusi qytetarët nuk do ta marrin?

Gentian Kallmi: Ne flasim në kuadrin institucional, aktualisht Bashkia Durrës ka gjetur më të drejtë zgjidhjen për financimin e objekteve sesa dhënien e bonuseve.

Edlira Devolli: Edhe diçka tjetër shkresën kur do na e bëni publike?

Korespondencën që është mbajtur me Ministrin përkatëse?

Gentian Kallmi: Shkresa do dorëzohet në zyrën përkatëse, për këtë besoj se edhe zoti Myshketa e ka në dispozicion.

Ani Dyrmishi : Faleminderit zoti Kallmi.

z. Myshketa pyetje?

Jonuz Myshketa: Përshëndetje të gjithëve!

Unë do të paramendoj me dy pyetje që janë bërë herës së kaluar për të cilat është vënë në dijeni në lagjen 7 uji i pijshëm, i cili realisht nuk është i pijshëm, ku në rubinetën e familjeve iu vinte me ngjyrë dhe erë, unë e bëra faktike dhe mbledhjen e fundit që ishim, me një bidon i marrë nga ajo zonë. Do dua një zgjidhje sa më parë për këtë problem dhe a është vepruar apo jo? Sepse nga banorët e zonës më është thënë që vazhdon e njëjta problematik.

Preferoni që t'ju bëj gjitha pyetjet dhe më pas...?

Gentian Kallmi: Po

Jonuz Myshketa: Okej (okay).

Rrishtaz jo më larg se para 3 ditësh kemi sinjalizim nga banorët e lagjes numër 8, pranë Drejtorisë së Policisë, ku ka probleme me tubacionet e ujërave të zeza, të cilat kanë dalë mbi sipërfaqen, është një problem jetësor pasi është një burim i madh infeksionesh, me erë kundërbuese ku nuk mund të kaloj kurrëkush. Do ju lutesha të vendosej në prioritetet e ndërmarrjes përkatëse duke bërë presionin e duhur që banorët të kenë një shërbim sa më cilësor. Dhe aty kalojnë fëmijë, kalojnë të moshuar, aty kalojmë ne, era është kundërbuese dhe është një problem infektiv. Kemi kaluar jo më pak para pak kohësh sëmundje të përhapura si Covid e tjera me rradhë.

Një pyetje e rradhës që nuk kam marrë përgjigje është për familjen Jambelli, e cila është klasifikuar sipas aktit të ekspertizës së thelluar DS4 e pabanueshme, në rajonin numër 5 dhe me Vendimin e Këshillit Bashkiak numër 114, datë 30.10.2020 nuk është marrë asnjë masë për këtë familje. Kërkoj një përgjigje në lidhje me masat që do merren me objektin në fjalë?

Dhe pyetja e fundit, ajo që si Parti Demokratike është denoncuar disa herë, në lidhje me pjesën e tërmetit për familjet, ose banesat, ose objektet dhe më saktë objekti në lagjen 17, por nuk është i vetëm, i cili është shpallur i pabanueshëm, por nuk ka nevojë për një akt ekspertize të thelluar, mjafton që secili prej nesh të kalojë përpara atij pallatit, ai duhet të ketë, ai objekt duhet të ketë një rrip sigurie ku njerëzit të mos kalojnë dhe jo më... Njerëzit të detyruar nga mosmarrja e bonusit të qerasë, e cila u çek dhe nga kolegja e nderuar znj.Devolli dhe ju dhatë përgjigje deri diku, janë detyruar të rikthehen në atë pallat. Pra kjo është një përgjegjësi drejtpërdrejtë e Bashkisë për monitorimin dhe menaxhimin e banesave.

Unë jam i qartë që Bashkia dhe bie dakord, që nuk ka pse të financojë nga buxheti i Bashkisë bonuset e qerave, nuk ka pse të financojë buxheti i Bashkisë rindërtimin e pallateve, kur kjo është një detyrë drejtpërdrejtë e Qeverisë, kur mos harrojmë që është ngritur një Ministri, Ministria e Rindërtimit, me një ish-ministër, që sot nuk dihet se ku është dhe janë marrë gati 1.2 miliardë euro fonde, ndihma, grante dhe kredi, të cilat paguhen nga të gjithë qytetarët shqiptarë dhe nuk ka pse xhepat e Bashkisë Durrës, me një buxhet të limituar, i cili mund të vendoset në funksion të emergjencave që qyteti ka.

Kërkoj me ngulm dhe një përgjigje. Unë shkresën e kam të them të drejtën, nuk dua të ripërsëris atë çfarë tha kolegja, por Bashkia në bazë të shkresës Mars 2023, nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, ka pasur dijeni që bonuset e qerave nuk do të merren më, por do të jenë barrë e Bashkive. Kjo nuk vlen vetëm për Bashkinë e Durrësit, por ne na intereson Bashkia Durrësit, e cila ishte më e prekura nga tërmeti 26 Nëntorit.

Theksoj faktin te këto objekte ose tek objekti në fjalë që kam qenë personalisht, kam hyrë brenda kam pyetur dhe kam kontaktuar dhe me banorët, nuk e di nga i buron frika pse ato nuk dalin, sepse frikë të dalësh të kontestosh një objekt i cili mund të kthehet në gërmadhë, larg qoftë një tërmet i dytë, mund të kthehet në varreza kolektive. Pra aty rrezikohet jeta, gjëja më e çmuar.

Se çfarë zgjidhje duhet të gjejmë këtu, këtë duhet ta bëjmë bashkarisht. Këtu nuk bëhet fjalë për ngjyra politike, bëhet fjalë për jetë njerëzish. Situata është alarmante, ajo na prek që të gjithëve. Banorët nuk duhet të kalojnë rreth e qark objekteve të tilla dhe jo më të banojnë aty, për shkak të mosmarrjes së bonusit të qerasë.

Unë këto kisha dhe në denoncimin tim publik e kisha kërkuar fjalën me kryetaren e Bashkisë, jeni ju, për mua njësoj, zgjidhja është emergjente, kërkesa është emergjente se bëhet fjalë për jetë njerëzish. Ju lutem të mos anashkalohet në asnjë sekond, dhe duhet të biem dakord të gjithë, të

majtë, të djathtë, të mesëm. Bëhet fjalë për jetë njerëzish dhe nuk mund të trumbetohet histori suksesi kur kemi jetë njerëzish të rrezikuara. Kaq kisha.

Ani Dyrmishi: Faleminderit!

Zoti Kallmi?

Gentian Kallmi: Faleminderit për pyetjet. Duke iu referuar pjesës suaj për sa i përket ujit të pishëm dhe ujërave të zeza, unë ju falenderoj për ngritjen e shqetësimit. Ne u vumë në dijeni për këtë rast, besoj keni patur kontakt dhe nga përfaqësuesit e Bashkisë lidhur me këtë rast. Kemi kontaktuar ndërmarrjen përkatëse, e cila do verifikojë me një grup të ngritur posaçërisht këto problematika, me qëllim konstatimin dhe zgjidhjen e problematikës.

Referuar objektit në lagjen 17, që edhe ju keni denoncuar publikisht, në vijim të asaj çfarë i thashë përpara për pyetjen e zonjës Devolli, ky është një nga gjashtë objektet që Bashkia ka vendosur ta financojë me buxhetin e Bashkisë rirforcimin e këtij pallati. Ka një projekt, projektzbatimi të përfunduar, i pajisur me oponencë teknike, dhe fondet për zbatimin do të përballohen nga buxheti i Bashkisë, për zgjidhjen e problematikës. Jemi në procedura aktualisht, procedurat burokratike të tenderimit, sipas ligjit në fuqi, dhe shumë shpejtë do fillojë puna.

Jonuz Myshketa: Okej.

Unë e përgëzoj Bashkinë në lidhje me rolin, pavarësisht se nuk jam dakord, duhet të jetë i Bashkisë, duhet të jetë e qytetarëve, sepse ai është pasojë e një gjendje të jashtëzakonshme.

Siç e thashë dhe më parë në fjalën time, Ministria e Rindërtimit, Qeveria, duhet të përballojë këto lloj shpenzimesh dhe shpenzimet e buxhetit të Bashkisë duhet të shkojnë për emergjencat që qyteti i Durrësit ka pa masë.

Duhet të theksoj faktin për këtë pallat, për banorët, çfarë do të bëjnë gjatë kësaj kohe, do të jetojnë në atë godinë e cila është e pabanueshme? Do t'i gjejmë një zgjidhje derisa kohë të marri rindërtimi dhe cila është koha që Bashkia bashkë me gjithë institucionet përkatëse, pretendon ose parashikon që ky objekt të jetë i banueshëm dhe i sigurtë për banorët?

Gentian Kallmi: Projektzbatimi normalisht ka dhe një grafik zbatimi punimesh. Në përfundim të lidhjes së kontratës operatorët ndërtues propozojnë dhe largimin e tyre, kështu që nuk mund të jemi në kushtet që të mund të parashikojmë se kur mund të përfundojë.

Ka një, është parashikuar një financim 2-vjeçar për këtë objekt. Në lidhje me zgjidhjen se ku do të shkojnë këta banorë, është një problem i qytetit të Durrësit, ose më saktë i Bashkive që janë prekur nga tërmeti. Ripërsëris prap faktin që buxheti i Bashkisë nuk mund t'i përballojë bonuset e qerasë, sepse si në rastin konkret ka preferuar të zgjidhi problematikën duke financuar zbatimin e punimeve, sesa fondet t'i angazhonin në dhënien e bonusit të qerave që nuk zgjidh problematikë.

Ani Dyrmishi: Pyetje nuk ka më.

Faleminderit të gjithëve!

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 24 (njëzetëkatër) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ALNEIDA RROSHI (humbi mandatin)

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Socialiste :

ROLANT XHELILAJ

Kryetar i Gr. Partisë Demokratike:

JONUZ MYSHKETA